



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

RAPORTIM  
I PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM  
“MBI ECURINË E VEPRIMTARISË SË PROKURORIVE  
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
PËR VITIN 2020”

**I nderuar zoti Kryetar,**

**Të nderuar zonja e zotërinj anëtarë,**

Viti që kaluam ishte mjaft i vështirë për shkak të pandemisë, e cila krijoi probleme edhe në funksionimin e sistemit të prokurorisë. Megjithatë, prokurorët dhe strukturat administrative e mbështetëse të saj, përballuan këtë situatë, dhe arritën rezultate në një sërë objektivash në fokusin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2020, të cilët janë ndjekur me përparësi, si nëpërmjet masave administrative dhe procedurale institucionale, siç janë miratimi i udhëzimeve të përgjithshme dhe planeve të veprimit për të unifikuar veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe mbikëqyrjen e zbatimit tyre, me synim rritjen e efektivitetit bazuar në një kuadër normativ të unifikuar, konsoliduar dhe sa më eficient në veprimtarinë institucionale, ashtu dhe nëpërmjet akteve të përbashkëta me disa institucione dhe agjenci ligjzbatuese ndërvepruese për të rritur kapacitetet institucionale e profesionale dhe eficientë të bashkëpunimit ndërinstitucional, ku veçojmë:

- Masat e marra për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020, nëpërmjet, si hartimit të Planit Veprimit për zbatimin e kërkesave të kësaj Rezolutive, i miratuar me urdhrin nr.103 datë 17.07.2020, ashtu dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij, me efekte në përmirësimin e rregulloreve standard të prokurorive të shkallës së parë dhe të apelit me juridiksion të përgjithshëm, me qëllim që të sigurojmë efikasitet në organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punës në çdo prokurori, ngritjen e disa strukturave funksionale në prokurori, forcimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në bashkëpunim me projektin PAMECA V dhe projektin EURALIUS V, si dhe rritjen e eficientë të bashkëpunimit, si ndërinstitucional në nivel qendror e vendor me miratimin e disa marrëveshjeve të bashkëpunimit dy dhe shumë palëshe, ashtu dhe bashkëpunimit ndërkombëtar me komandimin e prokurorit ndërlidhës pranë Eurojust;

- Masat e marra për zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave datë 24.06.2020, nëpërmjet, si miratimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.11/2020 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, ashtu dhe hatimit të Planit Veprimi “Për zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020” i miratuar me urdhërin nr.112/2020, dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij, me efekte në garantimin e pavarësisë së prokurorëve, forcimin e ligjshmërisë dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe rritja e bashkëpunimit e koordinimit ndërinstitucional.

- Masat e marra në drejtim të forcimit të pavarësisë së prokurorëve, mirëfunksionimit të zyrave të prokurorive dhe rritjes së efikasitetit të punës në çdo prokurori, ku mund të përmendim nxjerrjen e udhëzimit të përgjithshëm miratuar me nr.12/2020;

- Masat e marra në drejtim të forcimit të kapaciteteve institucionale dhe profesionale në luftën ndaj pastrimit të produkteve të veprës penale, krimit financiar dhe goditjes së aseteve kriminale, duke bashkërenduar punën me të gjithë institucionet ligjzbatuese të përfshira, si në krijimin dhe konsolidimin e një kornize normative të unifikuar edhe për koordinimin në nivel qendror e vendor, ashtu dhe në kryerjen e trajnime të përbashkëta ndërinstitucionale;

- Marrëveshja me Policinë e Shtetit, për mënyrën e trajtimit të një pjese të materialeve kallëzuese, e shoqëruar edhe me udhëzimin përkatës që hyri në fuqi këtë fillimviti, i jep zgjidhje një problemi të mbartur prej vitesh, lidhur me cilësinë e materialeve referuese;

- Masa e marra që synojnë përmirësimin e punës në prokurori në drejtim të respektimit të të drejtave të viktimave të krimit, veçanërisht ato të dhunës në familje dhe grupeve vulnerable. Këtu përmendim, nxjerrjen e një udhëzimi të përgjithshëm, organizimin e tryezave të diskutimeve dhe pjesëmarrjes në trajnime, masa këto që do të vijojnë të jenë në fokusin tonë edhe në vitin 2021.

## **I. ORGANIZIMI I BRENDSHËM, GJENDJA, PROGRESI, PROBLEMATIKAT DHE MBËSHTETJA QË KËRROHET.**

Për shkak të vakancave numri i përgjithshëm faktik i prokurorëve ka qenë 251, tregues që evidenton se 70 prokurorë i mungojnë prokurorive me juridiksion të përgjithshëm. Gjendja e numrit faktik të prokurorëve sipas nivelit të prokurorive ka qenë: 223 prokurorë, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, ose 55 prokurorë më pak për shkak të vakancave, 18 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit ose 8 prokurorë më pak për shkak të vakancave, dhe 10 prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme ose 7 prokuror më pak për shkak të vakancave. Krahasuar vetëm me vitin 2019<sup>1</sup> shifra në ulje në numrin faktik total është përkatësisht prej 18,77 % të prokurorëve.

Në kuadrin e përmirësimit të rregullave standard në organizimin dhe funksionimin e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm si dhe shmangien/parandalimin e shkeljeve të nenit 21 të ligjit nr.97/2016 në organizimin dhe funksionimin e seksioneve në disa prokurori, në datë 08.09.2020, me urdhrin nr.120 të

---

<sup>1</sup> Numri faktik i prokurorëve në janar 2019 ka qenë 309, përkatësisht 276 në shkallë të parë, 21 në prokuroritë e apeleve dhe 12 në Prokurorinë e Përgjithshme.

Prokurorit të Përgjithshëm, u miratuan disa shtesa në rregulloren standard të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

-Ndërkohë u vijua me procesin e rishikimit tërësor të këtyre akteve, dhe në datë 28.10.2020, me urdhrin nr.136 të Prokurorit të Përgjithshëm, u miratua rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme, ndërsa me urdhrin nr.164 datë 18.12.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm u miratuan dy rregulloret standard, për organizimin dhe funksionimin e prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm, ku përcakohen rregulla lidhur me, organizimin dhe funksionimin e secilës strukturë që kryen funksione procedurale dhe administrative sipas strukturës standarde<sup>2</sup>, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të çdo strukture, për të siguruar efikasitet në organizimin, drejtimin, koordinimin, dhe mbikëqyrjen apo monitorimin e punës në çdo prokurori.

Një ndër masat më të rëndësishme në drejtim të garantimit të pavarësisë së prokurorit, mirëfunksionimit të prokurorive, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në marrëdhëniet ndërmjet strukturave të prokurorisë, është nxjerrja e udhëzimit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i cili siç jeni në dijeni, shfuqizoi udhëzimin nr.8/2019 (i pezulluar), pas një procesi gjithëpërfshirës diskutimi. Objekt i udhëzimit nr.12, datë 20.07.2020, i ndryshuar, është garantimi i pavarësisë dhe autonomisë së prokurorit në ushtrimin e funksioneve procedurale në raport me detyrueshmërinë e ndjekjes penale, përcaktimi i raporteve prokuror - prokuror më i lartë, si dhe mënyra e informimit në të gjitha hallkat dhe nivelet e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

Akte të tjera me rëndësi në aspektin organizativ dhe funksional mund të përmendim: udhëzimi i përgjithshëm nr.8, datë 19.05.2020 “Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”; aktet në funksion të garantimit të informacionit “Sekret Shtetëror”; urdhëri nr.124, datë 24.09.2020 për “Përcaktimin e formës së regjistrit dhe mënyrën e mbajtjes dhe raportimit të të dhënave statistikore të çështjeve me të mitur, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”; udhëzimi i përgjithshëm nr.18, datë 31.12.2020, “Për masat administrative dhe procedurale për verifikimin e të dhënave të formularit të vetëdeklarimit nga struktura e posaçme në zbatim të ligjit nr.138/2015 dhe vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë”.

Gjendja e vakancave është tashmë e njohur se në të gjitha prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm ka e po krijohen në vazhdimësi vakanca të përkohshme e të përhershme kryesisht për shkak të rivlerësimit kalimtar. Situata është edhe më kritike në ato prokurori ku ushtron de facto funksionet vetëm 1 (një) prokuror, i cili është njëkohësisht edhe drejtues prokurorie. Për sa më sipër, përveç plotësimit me prokurorë nga Shkolla e Magjistraturës, është i domosdoshëm miratimi i hartës së re gjyqësore dhe për përmirësime në infrastrukturë

---

<sup>2</sup> Neni 20 në lidhje me nenin 38 pika 2 shkronja “e” e ligjit nr.97/2016;

nëpërmjet rritjes të kapaciteteve akomoduese me ambiente pune për prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, administratën dhe shërbimet mbështetëse në prokurori, me synim për të lehtësuar rritjen e ngarkesës dhe mbështetur veprimtarinë e prokurorëve me numër të reduktuar dhe pëmirësuar kushtet e punës, në gjithë sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm.

## **II. VEPRIMTARIA E PROKURORIVE, PROBLEMATIKAT DHE ÇËSHTJET QË KËRKOJNË VËMENDJE.**

### **1. Veprimtaria e prokurorive të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm**

Raporti mbi gjendjen e kriminalitetit dhe raporti mbi ngarkesën e punës të prokurorive për vitin 2020 që i janë vënë në dispozicion këtij Këshilli, paraqesin të dhëna të hollësishme për treguesit e punës dhe ecurinë e veprimtarisë për të gjithë prokuroritë.

Në këtë raportim, vlerësojmë të ndalemi në disa tregues të performancës së prokurorive, problematikat dhe disa çështje që kërkojnë vëmendjen tuaj.

Gjatë vitit 2020, janë trajtuar 58466<sup>3</sup> materiale kallëzuese që përbën një ulje prej 2,37 % në krahasim me vitin 2019. Janë ndjekur gjithsej 44834 procedime penale, që përbëjnë një rritje prej 1,23 % të procedimeve në krahasim me vitin 2019, nga të cilat 27890 janë procedime penale të regjistruara, me një ulje prej 9,29 % në krahasim me vitin 2019 dhe 640 janë procedime penale të rifilluara, që tregojnë rritje prej 9,59 % në krahasim me vitin 2019. Në vitin 2020 janë mbartur, 16304 procedime penale me një rritje prej 25,83 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2019, ndërkohë në vitin 2021 janë mbartur 18213 procedime, me rritje prej 11,7 % krahasuar me vitin 2020. Është vendosur mosfillimi për 13632 referime dhe kallëzime penale, që do të thotë një ulje prej 12,61 % në krahasim me vitin 2019.

Gjatë vitit 2020 janë përfunduar 26169 çështje që përbën ulje prej 7,14 % të çështjeve të përfunduara krahasuar me vitin 2019, prej të cilave: 38,11 % janë dërguar për gjykim<sup>4</sup>, 22,62% janë pushuar<sup>5</sup>, 35,93 % janë pezulluar<sup>6</sup> dhe 3,34 % janë transferuar në prokuroritë kompetente.

Janë dërguan në gjykatë për pushim 4647 çështje ose me rritje 53,16 % krahasuar me vitin 2019, prej të cilëve 2252 çështje janë pushuar për mungesë fakti, që përbën 48,46 % të çështjeve të pushuara. Nga të dhënat rezulton se për 233 çështje gjykata ka vendosur kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve ose me rritje 8,88 % krahasuar me vitin 2019, ndërsa në

<sup>3</sup> Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e mbartura; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2020 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2020; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2020.

<sup>4</sup> 9973 çështje

<sup>5</sup> 5920 pushuar gjithsej

<sup>6</sup> Të dhënat tregojnë se ndër 9402 procedime të pezulluara, 9400 prej tyre janë pezulluar për shkak se nuk njihet autori i veprës penale dhe 2 procedime janë pezulluar për shkak se i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm.

5 çështje gjykata ka vendosur kthimin e akteve dhe urdhërimin e formulimit të akuzës, tregues në ulje krahasuar me 12 vendime të tilla në vitin 2019.

Janë dërguar në gjykatë për kalimin për gjykim 9973 çështje me akuzë ndaj 11503 të pandehurve. Krahasimisht me vitin 2019 rezulton një ulje prej 4,07% e numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë dhe 5,39 % e numrit të të pandehurve dërguar në gjykatë.

-Në lidhje me vendimet e gjykatës, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2020 janë dënuar 8022 të pandehur dhe për 152 të pandehur është dhënë vendim për deklarimin të pafajshëm ose krahasuar me vitin 2019 me ulje 8,96 % e numrit të pandehur të dënuar dhe ulje 19,15 % e numrit të pandehurve të deklaruar të pafajshëm.

### ***ii) Përformanca e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë.***

Nga analiza në përqindje e raportit të çështjeve të përfunduara me procedimet e regjistruara në secilën prokurori për vitin 2020 evidentohet performancë më e ulët në Prokuroritë e rretheve gjyqësor Kavajë, Gjirokastrë, Berat, Dibër etj, ndërsa përformanca më e lartë evidentohet në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Tropojë, Pukë, Kukës e Kurbin.

Nga analiza në përqindje e raportit të procedimeve të përfunduara me çështjet e mbartura dhe procedimet e regjistruara, etj (procedimet në ndjekje) në secilën prokurori për vitin 2020, evidentohen treguesit si: nga performanca më e ulët që konstatohet në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Berat, ku janë përfunduar 34 % e procedimeve në ndjekje, e më pas vijon me rritje në rrethet Kavajë, Gjirokastrë, Sarandë, Dibër etj, deri në performancën më të lartë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat, ku janë përfunduar 97 % e procedimeve në ndjekje, në atë prokurori e që vijon në rend zbritës në rrethet Kukës, Pukë, Tropojë, Kurbin etj.

Raporti më sipër evidenton se prokuroritë me përqindje nën 50% të çështjeve të përfunduara brenda vitit 2020, dhe jo vetëm, me të njëjtin numër faktik të prokurorëve, vlerësojmë se mund t'ju duhej më shumë se 1 vit efikasitet punë për të përfunduar të gjitha çështjet në ndjekje, pa regjistruar procedime të reja, rrethana që evidentojnë nevoja emergjente për të plotësuar vakancat, për të normalizuar veprimtarinë në Prokuroritë e rretheve gjyqësore Berat, Kavajë, Gjirokastrë, Dibër, Sarandë, Shkodër, dhe jo vetëm.

-Ngarkesa e prokurorëve.

Ngarkesa mesatare për çështjet e përfunduara nga prokurorët në vitin 2020 janë: -më e larta 204 çështje të përfunduara në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Kurbin, dhe -më e ulta 41 çështje të përfunduara në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Kavajë, rrethana që evidentojnë nevojën për të rivlerësuar numrin faktik të prokurorëve në ato prokurori ku numri mesatar i ngarkesës për prokuror është i lartë dhe me tendencë në rritje të treguesve të procedimeve

në ndjekje, me synim unifikimin e ngarkesës së prokurorëve sa më afër nivelit mesatar të në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Mesatarja e çështjeve të regjistruara gjatë vitit 2019 në raport me numrin faktik të prokurorëve në rrethet gyqësore, 27890/223, rezulton të jetë në rang vendi 125 procedime penale për prokuror. Ky do të duhet ishte edhe treguesi rreth të cilit do të duhej të ishte edhe shpërndarja e balancuar e numrit të prokurorëve në rang vendi. Por nga të dhënat rezulton se rreth kësaj mesatare afrohen prokuroritë në rrethet Shkodër, Elbasan, Durrës, Fier, Lezhë, Kukës, Berat, Lushnjë, Vlorë, Korçë, Sarandë, Dibër dhe Tiranë, ku mesatarja e regjistrimeve të reja varion nga 104 në 143. Kanë një raport ndjeshëm të disfavorshëm në rrethet Kurbin, Mat, Pogradec, Gjirokastrë dhe Krujë ku shifrat variojnë nga 159-201, ndërsa rezultojnë me një mesatare të ulët rrethet Kavajë, Përmet, Tropojë dhe Pukë, ku mesatarja varion nga 83-42 procedime penale. Përtej kësaj shifre, nisur nga probleme të akumuluar në vitet e kaluara, nëse do të llogarisim ngarkesën faktike duke shtuar procedimet e mbartuara, situata rezulton shumë e rënduar në rrethet Berat, Pogradec, Krujë, Gjirokastrë, Sarandë me një mesatare të ngarkesës nga 311-489 procedime për çdo prokuror. Ngarkesa më e ulët mbetet në rrethet Pukë, Përmet, Tropojë, Kavajë, ku varion nga 89-175 procedime.

## **2. Veprimtaria e prokurorive të apelit me juridiksion të përgjithshëm**

i) Performanca e prokurorive pranë gjykatave të apeleve

- Procedime të regjistruara/procedime të përfunduara (Niveli i efikasitetit).

Raporti në përqindje i procedimeve të përfunduara me çështjet e regjistruara në secilën prokurori apeli për vitin 2020, evidenton treguesit, -nga performanca më e ulët 84% në Prokurorinë e Apelit Durrës, deri në performancën më të lartë 104 % në Prokurorinë e Apelit Tiranë. Ky raport evidenton dhe efikasitetin e punës të secilës prokurori apeli brenda vitit 2020, ku pasqyrohet gatishmëria dhe mundësia e secilës prokurori për të përfunduar brenda vitit procedimet e regjistruara.

-Ngarkesa e prokurorëve të apeleve.

Kjo paraqitja grafike evidenton se ngarkesa mesatare për çështjet e përfunduara nga prokurorët e apelit në vitin 2020 është më e larta prej 235 çështje të përfunduara në Prokurorinë e Apelit Shkodër dhe më e ulta me prej 152 çështje të përfunduara në Prokurorinë e Apelit Vlorë, rrethana që evidentojnë nevojën për të rivlerësuar numrin faktik të prokurorëve në ato prokurori ku numri mesatar i ngarkesës për prokuror është i lartë dhe me tendencë në rritje të treguesve të procedimeve në ndjekje, me synim unifikimin e ngarkesës së prokurorëve të apelit sa më afër me nivelin e ngarkesës mesatare në të gjitha prokuroritë e apelit pranë gjykatave të apeleve me juridiksion të përgjithshëm.

Veç sa më sipër, referuar disa treguesve të tjerë të performancës së prokurorive të apeleve, gjatë vitit 2020, evidentohet se prokurorët e apelit:

- kanë hequr dorë në 26 % të ankimeve të prokurorit të shkallës së parë për çështje themeli;

- kanë kërkuar në 4,06 % të kërkesave lehtësim të pozitës së të pandehurit (në 15,79 % të rasteve gjykata ka vendosur lënie në fuqi të vendimit);

- kanë kërkuar në 0,86 % të kërkesave prishjen e vendimit dhe vendosjen e pushimit ose pafajësi (në 12,5 % të rasteve gjykata ka vendosur lënie në fuqi të vendimit);

- kanë kërkuar në 1,60 % të kërkesave prishjen e vendimit dhe kthimi i akteve (në 40 % të rasteve gjykata ka vendosur lënie në fuqi të vendimit);

- gjykata ka mbështetur kërkesën e prokurorit të apelit për lënie në fuqi të vendimit të shkallës së parë në 75,45 % të rasteve dhe kërkesën e prokurorit për rëndimin e pozitës së të pandehurit në 14,10 % të rasteve.

### **3. Veprimtaria e Prokurorisë së Përgjithshme**

Në përmbushje të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, veprimtaria e Prokurorisë së Përgjithshme, përgjatë vitit 2020, ka vijuar hap pas hapi të marri formën e saj në realizimin e misionit dhe objektivave prioritare, përmbushjen e kërkesave/rekomandimeve të institucioneve kushtetuese dhe ndërkombëtare lidhur me prioritetet kyçe të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit, si dhe të angazimeve në zbatim të strategjive ndërinstitucionale.

Në kuadrin e ristrukturimit të Prokurorisë së Përgjithshme, në datë 03.02.2020 me urdhrin nr.29 “Për strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme” u miratua ristrukturimi i drejtorive dhe sektorëve dhe me urdhrin nr.136/2020 u miratua rregullorja për organizimin dhe funksionimin e strukturave të Prokurorisë së Përgjithshme, me qëllim riorganizimin dhe funksionimin e brendshëm të strukturave që kryejnë funksione procedurale dhe administrative të Prokurorisë së Përgjithshme dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të çdo strukture<sup>7</sup>, si dhe administrimin e dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të Prokurorisë së Përgjithshme, duke u garantuar pavarësia e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve të tyre.

- Risi në strukturën e re është dhe krijimi i strukturave koordinuese dhe monitoruese në Prokurorinë e Përgjithshme. Funksionet e Sektorit të Monitorimeve, i krijuar rishtas, si sektor përgjegjës për monitorimin e veprimtarisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, janë përcaktuese në drejtim të zbatimit të ligjshmërisë, garantimit të respektimit të pavarësisë së prokurorëve dhe rritjes së përgjegjshmërisë, respektimin e etikës, shmangien e konfliktit të interesit dhe respektimit të të drejtave të subjekteve të procedimit penal.

<sup>7</sup> Shih, urdhërat e Prokurorit të Përgjithshëm -nr.29 datë 03.02.2020 “Për strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme”; nr.29/1 datë 03.02.2020 “Për caktimin e strukturës faktike në Prokurorinë e Përgjithshme” dhe nr.136, datë 28.10.2020 “Miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë së Përgjithshme”; etj.

-Realizimi i kësaj përgjegjësie është parashikuar të kryhet nëpërmjet mbikëqyrjes së zbatimit të urdhrave dhe udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë, kërkimit të informacioneve periodike apo marrjes së informacioneve/indicieve dhe të dhënave rast pas rasti nga ankesat e prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm, oficerëve të policisë gjyqësore, institucionet apo shtetasit. Për gjetjet nga monitorimet propozohen zgjidhje afatshkurta dhe afatgjata, në nivel politikash, ndryshime në aktet normative dhe/ose kërkimi i inspektiveve tematike nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

3.3 Prokuroria e Përgjithshme, për të realizuar funksionet dhe detyrat kushtetuese e ligjore që ka në kompetencë është angazhuar për normimin dhe unifikimin e veprimtarive administrative dhe funksionale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm,

- Në këtë vështim, janë përgatitur e miratuar 38 akte nënligjore të Prokurorit të Përgjithshëm, prej të cilëve: -18<sup>8</sup> udhëzime të përgjithshme, -14<sup>9</sup> urdhëra për miratimin e rregulloreve standard, dhe rregullore të tjera të miratuara për normimin e veprimtarive të tjera administrative apo funksionale, si dhe -inicuar e përgatitur 6<sup>10</sup> akte të përbashkëta (dy dhe shumëpalëshe), me synim organizim e luftës ndaj kriminalitetit dhe rritjen e efikasitetit të hetimit, ku në vitin 2020 prioritet i është kushtuar veçanërisht luftës ndaj pastrimit të parave, mbrojtjes e viktimave dhe rritjes së efikasitetit të hetimeve në veprat penale me viktimë vunerabël.

3.4 Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar dhe ka kontribuar në raportimin e progresin në kuadrin e zbatimit të rekomandimeve të BE-së, ku institucionalisht jemi përfshirë në disa aktivitete.

i) Prokuroria e Përgjithshme, gjithashtu, është angazhuar dhe ka kontribuar, si në marrjen e masave administrative e procedurale dhe iniciimin e memorandumit të bashkëpunimit për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, ashtu dhe raportimin periodik të progresit në kuadrin e zbatimit të rekomandimeve Moneyval dhe planit të veprimit FATF/ICRG.

### **3.5 Monitorimi, gjendja, problematikat dhe mbështetja që kërkohet**

i) Prokurori i Përgjithshëm, në kuadrin e mbikëqyrjes së zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme dhe kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë, për të monitoruar si zbatimin, ashtu dhe si kanë ndikuar udhëzimet e përgjithshme në gjendjen e kriminalitetit në fushat e rekomanduara dhe efektivitetin e

---

<sup>8</sup> Shih, aktet normative të PP të miratuara në periudhës Janar- Dhjetor 2020 në Faqen Zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme.

<sup>9</sup> Shih, po aty, Akte të tjera normative të miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm;

<sup>10</sup> Shih, po aty, marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera;



ushtrimit të ndjekjes penale në fushat përkatëse, gjatë vitit 2020, periodikisht i ka kërkuar informacione drejtuesve të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm lidhur me masat e marra në zbatim të kompetencave ligjore të tyre, nëse kanë nxjerrë udhëzime të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, dhe nëse kanë marrë masa, për koordinimin e veprimtarisë me prokuroritë e tjera, apo për kërkimin e informacionit për ecurinë e procedimeve dhe/ose për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët lidhur me çështje konkrete, apo nxjerrjen e urdhërave për policinë gjyqësore lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre, me synim që të sigurojnë efikasitetin, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e prokurorisë, dhe efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurorët e prokurorisë që drejtojnë, duke garantuar pavarësinë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve kushtetuese e ligjore.

ii) Në këtë vështrim, në marrëdhëniet me drejtuesit e prokurorive lidhur me veprimtarinë organizative dhe administrative të tyre, evidentohen: -probleme në respektimin e afateve të përcaktuara me aktet ligjore dhe nënligjore për dërgimin në Prokurorinë e Përgjithshme të të dhënave statistikore periodike, kërkesave për informacion, raportimeve periodike tre mujore dhe vjetore, etj; -mospërmbushje të kërkesave për raportim dhe/ose informim sipas ligjit dhe -në zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme, etj.

Konkretisht, lidhur me informacionet e përcjella nga drejtuesit e prokurorive për masat e marra në zbatim të udhëzimeve të përgjithshme dhe akteve nënligjore të tjera, evidentohet se:

-Në disa prokurori drejtuesit e prokurorisë sipas ligjit kanë marrë, si masa administrative për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme dhe/ose hartimin e planeve të veprimit për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve dhe planeve të veprimit të Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu dhe masa procedurale për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme dhe/ose kërkuar informacion prokurorëve për ecurinë e çështje konkrete, duke garantuar pavarësinë e tyre;

-Në disa prokurori të tjera, drejtuesit nuk kanë paraqitur të dhëna mbi masa administrative dhe procedurale për zbatimin e udhëzimeve dhe planeve të veprimit të Prokurorit të Përgjithshëm, të nxjerrë në zbatim të Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve prioritare të KM, apo për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete, duke i zbatuar ato pjesërisht apo me mangësi, ndërsa konstatohet gjithashtu se ka mangësi apo vonesa në informimin mbi zbatimin e udhëzimeve dhe ngritjes së infrastrukturës përkatëse administrative për lehtësimin e kushteve për zbatimin e tyre.

Në kuadrin e paraqitjes Prokurorit të Përgjithshëm nga drejtuesit e prokurorive, brenda muajit shkurt 2021, të Raportit vjetor mbi ecurinë e punës së prokurorive për vitin 2020, janë verifikuar dhe vlerësuar raportet, nëse paraqitja, forma dhe përmbajtja e tyre është në përfaqësim me ligjin<sup>11</sup>, dhe me standartet e përcaktuara me aktin normativ e kërkesat e

---

<sup>11</sup> Shih, pikat 2, 3, 4 e 5 të nenit 50 “Raportimi vjetor te Prokurori i Përgjithshëm” i ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Prokurorit të Përgjithshëm<sup>12</sup>, si dhe është konstatuar se ka probleme në raportimin e punës nga ana e prokurorive:

iii) Në këtë kuadër, në vlerësimin institucional konstatojmë dhe vlerësojmë se rregullimi ligjor aktual vështirëson lidhjen organike efektive mes drejtuesve të prokurorive në prokuroritë e shkallës së parë dhe apeleve me Prokurorinë e Përgjithshme, në kuptim të ushtrimit të detyrave ligjore dhe kushtetuese, ndërkohë që angazhimet institucionale që dalin nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimet e Këshillit të Ministrave apo në raportet me organizma të tjerë ndërkombëtarë kërkojnë një nivel më të lartë kohezioni institucional.

Gjithashtu, vlerësimi i performancës çmojmë se kërkon një përfshirje më të madhe të Prokurorit të Përgjithshëm në procesin e llogaridhënies dhe evidentimit të përgjegjësive në zbatimin e masave administrative e organizative, për sa kohë ka impakt mbi funksionimin në nivel operacional në përditshmërinë e aktivitetit të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

#### **IV. Bashkëpunimi dhe mbështetja**

Për çdo strukturë të prokurorisë, bashkëpunimi ndërinstitucional, përfshirja në proceset konsultuese të akteve ligjore e nënligjore dhe mbështetja nga projektet e misionet ndërkombëtare, ka qenë një aspekt i rëndësishëm në zhvillimin e objektivave dhe prioriteteteve institucionale dhe ndërinstitucionale të vendit.

Gjatë vitit 2020 Prokuroria e Përgjithshme ka kontribuar me dhënien e opinionëve për reformimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor të dërguar për dhënie mendimi nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Komisioni i Çështjeve Ligjeve dhe Komisioni i Sigurisë të Kuvendit të Shqipërisë. Gjithashtu, kemi qenë proaktivë në identifikimin e nevojave për ndryshim në kuadrin ligjor, duke kërkuar edhe ushtrimin e nismave ligjore në institucionet përgjegjëse, ku përmendim ndryshimet në ligjin organik të prokurorisë për të mundësuar qasjen në bazat e të dhënave shtetërore, si dhe propozimet për ndryshime në Kodin Penal, etj.

Nga ana tjetër, është bashkëpunuar përgjatë vitit 2020 me Projektin EURALIUS V, Projektin PAMECA V dhe projektin SIDA, në organizimin e trajnimeve dhe përmirësimin e kuadrit nënligjor që rregullon veprimtarinë e prokurorisë në fusha të caktuara.

#### **1. Bashkëpunimi me SPAK**

---

<sup>12</sup> Shih, urdhërin nr. 330, datë 29.12.2016 “Për përmbajtjen e raportit vjetor të Drejtuesit të Prokurorisë”, Aneksi 1, dhe kërkesat në shkresës/qarkoren nr.68 prot., datë 14.01.2021 “Për paraqitjen e Raportit Vjetor 2020” të Prokurorit të Përgjithshëm.

Bashkëpunimi e koordinimi ndërmjet prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme (SPAK) është i një rëndësie thelbësore për goditjen e krimit të organizuar dhe identifikimin e vënien përpara përgjegjësive të çdo bashkëpunëtori në veprimtarinë kriminale. Akti i Koordinimit Institucional, i nënshkruar në datë 15.12.2020, ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe SPAK-ut, vlerësojmë se do të ndihmojë në bashkërendimin dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe procedurale ndërinstytucionale, duke respektuar veçoritë dhe kompetencat institucionale të parashikuara në ligj.

## **2. Bashkëpunimi me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë**

Bashkëpunimi me ILD në procesin disiplinor dhe inspektimin e prokurorive është i një rëndësie të veçantë, për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësi kushtetuese e ligjore, bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të efijencës së sistemit të drejtësisë.

Me krijimin dhe fillimin e funksionimit të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në Shkurt 2020, në zbatim të nenit 283 e vijues të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë” dhe urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.40, datë 07.02.2020 “Për kalimin e ankesave dhe akteve disiplinore Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Prokuroria e Përgjithshme i ka dërguar Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë për kompetencë 52 praktika lidhur me ankesa dhe/ose materiale në proces verifikimi dhe hetimi disiplinor.

Për vitin 2020, në 1 rast, për shkeljet e konstatuara të një magjistrati/prokuror është përgatitur materiali dhe i është kaluar për inicim të procesit të inspektimit, Zyrës së Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë.

Vullneti i të dy institucioneve për të ngritur më tej këtë bashkëpunim dhe për të vendosur kontakte të drejtëpërdrejta për shkëmbimin e informacionit është objekt i marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar në datë 05.02.2021.

Në vitin 2021 është kërkuar hetimi disiplinor i tre prokuroëve dhe një drejtuesi prokurorie si dhe inspektimi tematik i 8 prokurorive.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**OLSIAN ÇELA**